

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN MILOT, LEZHË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Milot, Lezhë, me objekt: “Mbi vlerësimin aktivitetit ekonomik financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve dhe lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, vlerësimin për shitjeve të trojeve nën objekt, shtitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve prone publike, funksionimi i policisë komunale, etj.” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.43, datë 29.03.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 387/11, datë 29.03.2012, dërguar z. **Behar Haxhiu**, Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Bazuar në VKM nr. 770 datë 21.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisve të qeverisjes vendore, Komunës Milot, të Qarkut Lezhë” si dhe nr. 1054 datë 16.07.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Milot, të Qarkut Lezhë”, të kryhet verifikimi i pasurive të paluajtshme, të inventarizohen sipas objekteve, të regjistrohen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe në kontabilitet.

Menjëherë

2. Të rishikohen bilancet kontabël të viteve, 2010-2011, të saktësohen e të paraqiten sipas analizave aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe aktivet qarkulluese, në mbështetje të inventarizimit fizik, të paraqiten diferencat, nëse ka në këshillin e komunës dhe bazuar në vendimin përkatës të kryhen sistemimet. Gjithashtu, të rivlerësohen objektet, shkolla e kopshte të paraqitura në inventar me vlerën që kanë patur para vitit 1990 .

Menjëherë

3. Nga ana e administratës së Komunës, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të hartohet dhe të miratohet në Këshillin e Komunës, Rregullorja e Brendshme e Komunës “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Komunës Milot”,

Menjëherë

4. Nga ana e Këshillit të Komunës, të miratohet struktura e re e administratës, duke kryer reformim të argumentuar të strukturës ekzistuese sipas vendeve të punës, dhe legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

5. Sipas gjendjes së llogarive datë 30.09.2011, të derdhen në llogaritë e institucioneve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, vlerat respektive, 264.794 lekë dhe 164.545 lekë, si detyrime të prapambetura.

Menjëherë

6. Të nxirret përgjegjësia materiale, për daljen jashtë funksionit të mjetit tip gjurmimi “Skrep”, i pasqyruar në inventarin e komunës, në vlerën 1.999.000 lekë, dhe të merren masa për rivënien e tij në punë, ose nxjerrjen në ankand për shitje, sipas ligjit.

Menjëherë

7. Të kontabilizohet në llogarinë e debitorëve, shuma e detyrimeve për vitet 2009 - 2010, respektivisht 2.704.375 lekë dhe 3.549.115 lekë, në emër të subjekteve tatimpaguese, sipas listave bashkëlidhur procesverbalit nr.6, datë 24.10.2011 dhe në zbatim të ligjit nr.10418 datë 21.04.2011 “Për legalizimin dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” dhe udhëzimeve të MF, të shkarkohen për pjesën e detyrimeve të falura, ndërsa detyrimet që mbetën të arkëtohen në buxhetin e Komunës.

Menjëherë

8. Në kontratat e sipërmarrjeve të ndërtimit, për objektet që kanë afat përdorimi të gjatë, afati i garancisë të vendoset në përputhje me nenin 866, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” me ndryshime, jo më pak se 10 vjet.

Vazhdimisht

9. Të pezullohet me mirëkuptim ndërmjet palëve, ose në rrugë gjyqësore, zbatimi i kontratës me objekt : “Pastrim, grumbullim dhe transport i mbeturinave të qytetit” e lidhur me datë 25.12.2010, deri në dokumentimin dhe argumentimin e volumeve faktike të punimeve, duke ju referuar vërejtjeve të evidentuara në kapitullin IV/B.4, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit, dhe në përfundim, nëse konstatohen volume fiktive, të hiqen nga kontrata. Gjithashtu, të zbritet nga kontrata vlera e kazanëve të mbeturinave prej 417.600 lekë, dhe të shtohet pjesa e amortizimit vjetor të tyre, sipas normave ligjore të amortizimit.

Menjëherë

10. Të pezullohet dhënia e lejeve të shesheve dhe të ndërtimit, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit Milot, nga KRRTRSH-ja.

Menjëherë

11. Të ngrihet një grup pune me specialist të fushës, për rivefikimin e zbatimit të punimeve në objektet : “Rikonstrukcion shkolla 9 vjecare Shullaz dhe ndërtim 4 klasa të reja” dhe “Rikonstrukcion Rrugë Kryesore Qyteti Milot”, ku në veçanti të verifikohen, 15 zërat e punimeve me vlerë 1.807.320 lekë në objektin e parë dhe 6 zëra me vlerë 650.184 lekë në objektin e dytë, për të cilat gjatë kontrollit të dosjes së zbatimit mungonin librezat e masave, të cilat u paraqiten të plota pas konstatimit nga kontrolli.

Deri me datë 30.04.2012

12. Të ngrihet një grup pune me specialist të fushës, për vlerësimin real të autoveturës së blerë sipas kontratës së lidhur me datë 04.02.2009, duke u bazuar në vlerësimin doganor me datën e hyrjes në Shqipëri dhe nëse dalin diferenca me çmimin e blerjes, të ngarkohen me përgjegjësi materiale personat që kanë kryer procedurat e blerjes.

Menjëherë

13. Të bëhet riorganizimi i Këshillit të Rregullimit të Territorit (KRRT) të Komunës, në përputhje me nenin 17, të ligjit nr. 8405, date datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, me

ndryshime, VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, ose kompetencat e saj të delegohen pranë KRRT-së, së Qarkut Lezhë.

Menjëherë

14. Kryetari i Komunës dhe Zyra e Urbanistikës, të pezullojnë dhënien e lejeve të shfrytëzimit, deri në plotësimin nga përfituesit e lejeve të ndërtimit, të dokumentacionit që mungon në dosjet përkatëse.

Menjëherë

15. Të riorganizohet struktura e Policisë së Komunës dhe Inspektoratit Ndërtimor, dhe të behët rekrutimi i punonjësve, sipas kërkesave të ligjeve, nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”, ndryshuar me ligjin nr.8335, datë 23.04.1998 dhe nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektoratin e Ndërtimit”, duke marrë në konsideratë vërejtjet e evidentuara.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit shkaktuar buxhetit të Bashkisë, në vlerën **6.587.689 lekë**, si më poshtë :

1. Vlera **341.024 lekë**, nga [REDAKTUAR] për përfitim të padrejtë, shpenzime udhëtimi jashtë shtetit, pa plotësuar dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 7 të VKM nr. 228, datë 23.4.2004 “Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore” dhe VKM nr. 304, datë 08.5.2003 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive dhe institucioneve buxhetore kur dalin jashtë shtetit” pikat 3, 5 dhe 6.

2. Vlera **49.252 lekë**, nga [REDAKTUAR] për pagë të përfituar mbi kohën normale në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 85 pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” me ndryshime dhe në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, mbasi janë kryer pagesa edhe për ditë të Shtuna e të Diela.

3. Vlera **1.800.000 lekë**, nga 36 persona, sipas listës përkatëse, student që kanë përfituar ndihmë financiare në kundërshtim me nenin 3, pika 12 “Fondi i rishpërndarë”, nenet 13, 40 dhe 44 pika “a” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

4. Vlera **161.348 lekë**, nga [REDAKTUAR], projektues i objektit “Ura këmbësore e varur Skuraj”, përfituar për projektin më tepër, në kundërshtim me tarfat e përcaktuara në VKM nr. 444, datë 05.09.1944, “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit” .

Menjëherë

5, Vlera **112.220 lekë**, nga [REDAKTUAR] mbikqyres i punimeve në objektin “Ura këmbësore e varur Skuraj”, përfituar më tepër për mbikqyrjen e punimeve, në kundërshtim me tarfat e përcaktuara në VKM nr. 444, datë 05.09.1944, “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit.

Menjëherë

6, Vlera **358.327 lekë**, nga [REDAKTUAR] projektues të objektit “Ujësjellësi i Qytetit Milot”, përfituar më tepër, për projektin, në kundërshtim me tarfat e përcaktuara në VKM nr.

444, datë 05.09.1944, “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit”.

Menjëherë

7, Vlera **3.765.518 lekë**, nga përfituesit e lejeve të ndërtimit për taksa të pa paguara, sipas listës nr.1 bashkëlidhur (*Trajtuar hollësisht në kapitullin VI/B.11 të Raportit Përfundimtar të Kontrollit*).

Deri me datë 30.06.2012

C-MASA DISIPLINORE

Mbështetur ne nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe, Kontratën Individuale të e Punës, të jepen masa disiplinore:

“Largim nga puna”, për :

1. z. [REDAKTUAR], me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, njeheri Sekretar i KRRT-së së Komunës, për shkelje të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” neni 50/1 me ndryshime, dhe VKM nr.722, datë 19.11.1998 “Mbi miratimin e rregullores së urbanistikës”, pasi, ka pranuar dhe kaluar për miratim në KRRT, 24 kërkesa për leje ndërtimi pa dokumentacionin e duhur ligjor, gjë e cila në bazë të nenit 50/1, të ligjit të më sipërm përbën mospërbushje të rregullt të detyrës (*Shkeljet e kryera janë trajtuar në kreun e VI/B të Raportit Përfundimtar të Kontrollit*).

“Vërejtje me paralajmërim” për punonjësit;

- 1, [REDAKTUAR] me detyrë përgjegjëse në sektorin e financës për;
- mosplotësim të dokumentacionit në mbështetje të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël të përgjithshëm" të ndryshuar si dhe kritereve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë Financave “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2008 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisive që varen prej tyre.”
 - pasaktësi të pasqyrimit të gjendjeve të llogarive debitore e kreditore në bilancin kontabël 2010.
 - mos shoqërimin me dokumentacionin e kërkuar hyrje e dalje nga magazina të vlerave jashtë përdorimit, si dhe mos emërimi i komisionit të asgjësimit, duke mos gjetur zbatim të plotë kriteret e përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë Brendshme nr.1151 datë 16.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese”
 - lejimin e kryerjes së veprimeve në kundërshtim me nenet 13, 40 dhe 44 pika “a” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” gjatë zbatimit të buxhetit.
 - pasqyrim jo të plotë të vlerës së ndihmës së akorduar nga World Vision dhe vlerës së plotë të objekteve të ristrukturuar në këtë bashkëpunim me vlerën e plotë të situacioneve.
 - mos rakordim sistematik me zyrën e tatim taksave dhe të urbanistikës në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.
- 2 [REDAKTUAR] me detyrë llogaritare për:
- mos kontroll të plotësimin të dokumentacionit hyrje e dalje nga magazina, me dokumentet provizore periodike, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara ligjin nr. 6942 datë 25.12.1984 “Për administrimin, dokumentimin, ruajtjen e qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, dhe në VKM nr. 70 datë 11.03.1985.

- pranim dokumentacioni të pa rregullt, pasi bashkëngjitur likuidimeve të kryera me bankë për objektet në zbatimin e marrëveshjes me World Vision faturat janë paraqitur e pranuar vetëm me vlerën e likuiduar nga komuna që nuk përputhet me vlerën e plotë të situacionit.

3. [REDAKTUAR] me detyrë magazinier, për;

- mosplotësim e shoqërim të dokumentacionit hyrje e dalje nga magazina me dokumentet provizore periodike, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara ligjin nr. 6942 datë 25.12.1984 “Për administrimin, dokumentimin, ruajtjen e qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, dhe në VKM nr. 70 datë 11.03.1985.

4. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për;

- mungesë të plotësimit të dokumentacionit dhe për programim të pa saktë të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

- mungesë kontrolli në zënien e hapësirave publike nga ana e subjekteve fizike e juridike.

- mos vendosjen e ngarkesës tatimore të subjekteve fizike sipas xhiros së vetdeklaruar.

- lejimin e ushtrimit të aktivitetit të subjekteve pa u pajisur me kasa fiskale

- mosrakordim me DRSHA për automjetet në pronësi të banorëve dhe ZVRPP të pasurive që disponohen në territorin në administrim të komunës.

- mosbashkëpunim institucional me policinë e komunës.

- mos rakordim sistematik me zyrën e financës dhe të urbanistikës në lidhje me arkëtimin e të ardhurave për kontabilizimin e tyre .

Shënim:

1-Për [REDAKTUAR] ish përgjegjës i sektorit të shërbimeve nuk propozohet masë disiplinore pasi konsiderohet e ezaurur për shkak se është larguar nga institucioni dhe kanë shkëputur marrëdhëniet me Komunën.

2-Për ish titullarin e Komunës [REDAKTUAR], për shkelje të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” nenet 5, 11,12 dhe 21 si dhe ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për pagesat e kryera me objekt: “*Shpenzime për shpronësim trualli dhe dru frutorë*”, në tejkalim të kompetencave (*trajtuar hollësisht në faqen ... të Raportit Përfundimtar te Kontrollit*), nuk propozohet masë disiplinore pasi, vendimet janë marrë në mënyrë kolegjiale nga Këshilli i Komunës dhe për shkak se Ai është larguar nga institucioni, pas zgjedhjeve vendore të fundit.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Në zbatim të nenit 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007, Kreu X, të kërkohet nga APP-ja, që për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për prokurimet e zhvilluar në periudhën 2009 - 2011, **të marrë masa për personat e mëposhtëm:**

D/1, Për anëtarët e Njesisë së Prokurimit ;

[REDAKTUAR], jurist,

[REDAKTUAR] specialist,

[REDAKTUAR], Specialiste ; pasi gjatë zhvillimit te procedurave të prokurimit në 6 tendera, kanë kryer disa shkelje ligjore, siç janë ;

a. Në llogaritjen e kufirit monetar. Njesia e Prokurimit (NP), ka marrë për bazë vlerën e preventivave të hartuar nga projektuesit, cmimet e të cilëve nuk janë bazuar në analizat teknike të cmimeve të miratuara nga organet shtetërore, gjë që bie në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për prokurimin publik”,

kreu II, pika 2, shkronja "c", VKM nr.514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjës së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", pika 2, ku përcaktohet qartë se për llogaritja e vlerës limit, bëhet në bazë çmimeve zyrtare të publikuara, çmimet e tregut, apo përvoja e mëparshme, gjë që ka shkaktuar edhe dem ekonomik për buxhetin e Shtetit apo të Bashkisë.

b. Në hartimin e dokumenteve të tendërit. NP, në rastin e dokumentacionit teknik, nuk ka administruar në dosje, dokumente që të vertetojnë se projektet e preventivat, e hartuar nga projektuesit, janë zyrtar, e konkretisht mungojnë ;

-zhvillimi i procedurës së prokurimit për përzgjedhjen e projektuesit, dhe kontrata e porosisë, -detyra e projektimit,

-projektideja dhe preventivi paraprak,

-akti i marrjes në dorëzim të projektit, miratimi nga Kryetari dhe Sekretari i KRRT-së,

-dokumentet e tjerë standart, të cilët janë nën përgjegjësinë direkte të NP për tu hartuar, në disa raste nuk janë plotësuar dhe zyrtarizuar sipas formes ligjore.

Veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, nenet 41 dhe 46, VKM nr.1, datë 10.01.2007, Kreu V, pika 2, shkronja a, dhe ngarkojnë me përgjegjësi personat e sipërshtuar.

c. Në lidhjen e kontratave, nuk është parashikuar afati i garancisë së punimeve sipas nenit 866, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", me ndryshime, ku afati i garancisë për objektet që kanë destinacion përdorimi afat gjatë, është 10 vjet, gjë që ngarkon me përgjegjësi juristin e NP që ka konceptuar kontratat, etj.

D/2, Për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

██████████ Kryetar,

██████████ Anëtare,

██████████ Specialiste,

██████████ Specialist,

██████████ Specialist, pasi, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit në 5 tendera, kanë kryer shkelje ligjore, e konkretisht disa prej tyre ;

-Në të gjitha rastet e zhvillimit të tenderave, mungojnë analizat e çmimeve të ofertave të operatorve, në kundërshtim me VKM NR. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjës së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit", pika 2. Në tenderat, me objekt "Studim dhe projektim Ujësjiellësi i Qytetit Milot" "Rikonstrukcion Shkolla Shullaz", "Rikonstrukcion Rruget e Qytetit Milot", kontratat e bashkëpunimit të operatorve të shpallur fitues janë të parregullta ose mungojnë, gjë që bie në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu VII-të, pika 2, shkronja b. Në tendërin me objekt : "Blerje Autoveture", vlerësimi i ofertave është bërë në mungesë të specifikimeve të teknike, është kualifikuar, dhe shpallur fitues operatori "COMBEA", pa licensë profesionale për llojin e mallrave objekt i kontratës dhe pa realizuar kontrata të ngjashme më parë, veprime që bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, nenet 1, 55 dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007, kreu IV-të, pika 5, shkronja c, etj.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Pal Gjoni dhe Margarit Stefa. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT